




STOP
Human Trafficking



Ruani lirinë e marrjes
së vendimeve për
jetën tuaj,
ruani jetën tuaj

Tregtia me njerëzit është shitja, blerja dhe mbajtjen e personit me qëllim të shfrytëzimit seksual, punës së detyruar pa shpërblim në të holla, detyrim për të lypur, detyrim për të kryer vepra penale, tregti me organe, duke përfshirë keqtrajtim fizik, dhunim, frikësim, shfrytëzim seksual, si dhe forma të tjera të detyrimit, terrorizimit dhe frikësimit për shfrytëzim të mëtejshëm.

Shenjat që na lajmërojnë për tregtinë me njerëz:

- kushtet e këqija, shpesh çnjerëzore për banim, mos zotërim të sendeve personale dhe të pareve;
- mospasje e dokumenteve personale, zotërimi i dokumenteve të falsifikuara, deklarata të rreme në kuptimin e moshës së vërtetë;
- të qenit të frikësuar, të përulur, me mëdyshje, mungesë konsekuence në deklarimin e të dhënave, veçanërisht të adresës së banimit, mungesë e orientimit gjeografik, të qenit të paushqyer, hematoma, dëmtime trupore që duken qartë se janë shkaktuar si rezultat i sulmimit fizik ose të masave të kontrollit;
- lëvizje të shumë personave në grup, të cilët nuk njihen midis tyre, fëmijë që udhëtojnë të pa shoqëruar nga të rriturit ose në grupe me persona me të cilët nuk kanë lidhje;
- fëmijë që kërkojnë leje nga bashkudhëtari, me ndihmën e shenjave, dhe që prania e bashkëshoqëruesit i bën të jenë të shqetësuar ose nervozë.

Shenjat që na lajmërojnë për tregtinë me njerëz me qëllim të shfrytëzimit për punë :

- jetojnë në grupe në të njëjtin vend ku punojnë dhe rrallë largohen nga këto objekte ose nuk dalin aspak;
- nuk kanë veshje të përshtatshme dhe pajisje mbrojtëse për punë, nuk janë të paguar për punën e tyre dhe nuk kanë kontratë pune, punojnë jashtë orarit të punës;
- nuk largohen asnjëherë nga vendi i punës pa praninë e punëdhënësit të tyre;
- nuk janë të lirë të lëvizin.

Treguesit për viktimat e tregtisë me njerëz për qëllim shfrytëzimi seksual:

- kufizim i lirisë së lëvizjes dhe komunikimit;
- kanë tatuazhe karakteristike ose, në rast se janë në grup, kanë tatuazhe identike;
- jetojnë ose udhëtojnë në grup, ndonjëherë me gra të tjera të cilat nuk flasin të njëjtën gjuhë, kanë shumë pak rroba ose veshje që është e zakonshme për punë seksuale;
- dinë vetëm fjalë të lidhura me seksin në gjuhën lokale ose në gjuhën e klientëve;
- ekzistencë e lidhjes së dashurisë me trafikantin;
- dëmtime trupore të natyrës seksuale.

Treguesit e tregtisë me njerëz me qëllim për të lypur dhe të detyrimit për të kryer vepra penale

- fëmijë, persona madhorë, ose imigrantë me invaliditet, që shërbejnë për të lypur në vende publike dhe në transportin publik;
- fëmijë që transportojnë dhe/ose shesin narkotikë të ndaluar;
- persona që kanë dëmtime fizike, që janë rezultat i sakatimit;
- marrin pjesë në aktivitete të bandave të organizuara kriminale;
- gjendje të keqe fizike e psikike, të lënë pas dore, higjienë të keqe personale, të pa ushqyer.

Treguesit që fëmija është në rrezik potencial që të bëhet viktimë e martesës së të miturit

- largim nga shtëpia;
- shtatzënësi në moshë të hershme;
- mungesa ose mungesa për një kohë të gjatë nga shkolla, frikësim i fëmijës për shkak të pushimeve shkollore, gjendje e keqe psikike – ankth, depresion, frikë;
- mbikëqyrje e lëvizjes nga ana e kushërinjve;
- vëllezër ose motra që janë detyruar me forcë për tu martuar ose që janë viktimat e martesave të të miturve.

Në rast se:

- jeni viktimë e tregtisë me njerëz ose keni dijeni që dikush është viktimë (potenciale) e tregtisë me njerëz,
- juve ju detyron dikush që të bëni diçka që e dini se është e ndaluar, bile edhe në rastin kur e keni bërë tashmë atë gjë,
- keni dijeni ose dyshime për vendndodhjen ose organizatorët e tregtisë me njerëz,

mos u frikësoni, BËNI KALLËZIM!

Në nivelin lokal në Bar, Berane dhe Podgoricë veprojnë tre ekipe të gatshme për parandalimin dhe identifikimin paraprak të viktimave potenciale të tregtisë me njerëz. Çdo ekip ka një jurist, një psikolog, një punonjës social dhe një përfaqësues të Ministrisë së Punëve të Brendshme, e kjo për të kryer vlerësime paraprake të rrezikut, dhënie të informacioneve dhe, sipas nevojës, rekomandimin në shërbime dhe institucione kompetente për këtë qëllim.

Në rast se keni dijeni ose keni dyshime që bëhet fjalë për tregti me njerëz, drejtoheni ekipit të gatshëm më të afërm në numrin e telefonit:

+382 69 388 965

Për informim dhe këshillë, mund ti drejtoheni zyrës së Qendrës Juridike nga ora 11:00 deri në orën 13:00 çdo ditë pune:



Pravni centar
Podgorica - ul.Jovana Tomaševića br.31/6



+382 20 230 913



pravnicentar@t-com.me



pravnicentar.co.me



Pravni centar

**Telefoni i kontaktit
për kallëzimin e kësaj
vepre penale është:**

122

Linja SOS për viktimat e tregtisë me njerëz është za 11 6666, me anë të të cilës mund të kallëzoni pa pagesë dhe në mënyrë anonime, 24 orë në ditë, dyshimin për kryerjen e kësaj vepre penale, të kërkonti më shumë informacion për vetë këtë fenomen dhe për shërbimet që ofrojnë ndihmë dhe mbështetje.

Kjo broshurë është mbështetur nga ana e Projektit Rajonal për Parandalimin dhe Luftimin kundër Tregtisë me Njerëz, të cilën e ka porositur Ministria Federale e Bashkëpunimit dhe Zhvillimit Ekonomik (BMZ), që e implementon Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) në bashkëpunim me OJQ-në Qendra Juridike.

Përmbajtja e këtij publikimi përfaqëson mendimet e autorit (autorëve) dhe nuk është e detyrueshme që të jetë qëndrim zyrtar i Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH.